REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 256/19
Datë/Datum. 29.05.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: *ADMINISTRATEN TATIMORE TË KOSOVËS*
Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr. i Prokurimit	**11600**	**19**	**1260**	**221**
Nr. i brendshëm Prokurimit[1]	**11600**	**17**	**004**	**221**

(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit

Sa i përket tenderit për **(Pastrimi dhe mirëmbajtja hixhenike e objekteve sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së)**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

LAGUNA SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Vllezerit Fazliu Nr.385
(Adresa)
Prishtinë — *10 000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*
045 900020 — _____
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Lorik Azemi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
lagunashpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

SH.P.K LAGUNA Prishtinë

29.05.2019
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

1.Njoftimi për kontratë në e-prokurim më 18.03.2019
2.Letra standarde e kërkesës për sqarim në e-prokurim më 29.03.2019
3.Procesverbali i hapjes së ofertaave në e-prokurim më 08.04.2019
4.Letra standarde për sqarim në e-prokurim më 14.05.2019
5.Dërgimi i sqarimit në e-mail më 15.05.2019
6.Njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm në e-prokurim më 17.05.2019
7.Kërkesa për Rishqyrtim pran AK-së në e-prokurim më 20.05.2019

8.Pezillumi I aktivitetit të prokurimit më 20.05.2019 *9.Vendimi mbi Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim në e-prokurim dhe e-mail më 22.05.2019*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	x				**Jo**	x

Procesi i hapjes ka qenë në rregull

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	x				**Jo**	

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 59 – LPP-së **Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Kompania e pastrimit Laguna sh.p.k. ka marrë pjesë në tenderin e organizuar nga Administrata Tatimore e Kosovës. me numer të prokurimi :**11600/19/1260/221** , numer të brendshëm : **11600/17/004/221** dhe me titull: **Pastrimi dhe mirëmbajtja hixhenike e objekteve sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së**. Sa i përketë këtij aktiviteti të prokurimit ne konsiderojmë dhe vlersojmë që **AK-ATK** e ka shkel nenin **59 të LPP-së** duke ekzamini,vlersu dhe krahasu tenderët në mënyrë të gabuar dhe të njëanshme.Në dosjen e tenderit tek specifikimet teknike të detyrueshme janë kërkuar **25 puntorë** me paga brutto prej **270.94** euro ose **250.00** neto. Ne vlersojmë që **AK-ATK** kompanin të cilën e ka shpallur fituese nuk e ka respektu këtë pagë prej **270.94** brutto apo **250.00** netto. Në vijim ju a paraqesim se si kalkulohet paga e puntorit:

   1. **Paga për një puntorë 270.94 euro**
   2. **Kontributi i puntorit 5% që i bie 13.55 euro**
   3. **Kontributi i punëdhënësit 5% që i bie 13.55 euro**
   4. **Tatim në paga 7.39 euro**
   5. **Paga netto për një puntorë 250.00 euro**
   6. **Gjithësej paga e puntorit me gjitha obligimet arrin në 284.49**
   7. **284.49 x 25 puntor = 7,112.25 euro**
   8. **7,112.25 x 18% tvsh= 1,280.21 euro**
   9. **7,112.25 + 1,280.21 = 8,392.46 euro**
   10. **8392.46 x 12 muaj =100,709.52 euro**

Opertaratori i cili është shpallur fitues është me një qmim vjetor prej **100 078.08** euro ose mujor prej **8,339.84** euro. Ky operator është **-631.44** euro vjetor ose **52.62** euro mujore nën qmimin

real me paga dhe TVSH **duke mos e përfshirë edhe materialin higjenik**. Kjo është një pasqyrë financiare e cila argumenton shumë qartë se Operatorët Ekonomik të cilët kanë ofertuar nën këtë qmim nuk e kanë respektuar pagen e puntorit prej 270.94 euro brutto ose 250 netto të cilën AK-ATK e ka kërkuar në dosjen e tenderit. Vlen të potencohet se për shërbime TVSH-ja është 18%. Faturimi i cili i bëhet AK-së në momentin e dorëzimit pas kryerjes së shërbimeve është 18% dhe aty nuk ka TVSH të zbritshme. Qdo Operator Ekonomik në dosjen e tenderit kanë qenë të obliguar ta kalkulojnë TVSH-në 18%. Është përgjegjësi e OE të deklarojnë TVSH qdo muaj në ADMINISTRATEN TATIMORE TË KOSOVËS 18% sipas të hyrave të tyre dhe shpenzimeve. Përderisa një Autoritet Kontraktues vendos specifika me të cilat kërkon që të respektohen ato paga nga ofertuesit atëherë edhe vlersimi i ofertave nga AK-ja duhet të jetë i drejt dhe të respektohen ato specifika. Sa I përketë Refuzimit të Kërkesës për Rishqyrtim ne e kundërshtojm atë ngase AK-ATK në mënyrë të pakuptimit me supozime dhe duke ju shmangur në mënyrë profesionale kritereve të dosjeve të tenderit me saktësisht specifikave të tyre ka refuzuar Kërkeson për Rishqyetim. Metoda e llogaritjes e kompanisë Laguna sh.p.k. është plotësisht e drejt. Pjesa II lista e qmimeve është e vërtet që është kërkuar qmimi për m2 mirpo te specifikat e dosjes së tenderit janë kërkuar 25 puntor me paga prej 270.94 euro brutto dhe këto paga secili ofertues ka qenë I obliguar ti respektoj duke llogaritur + 5% nga punëdhënsi shtes e që është obligim ligjor dhe pastaj edhe TVSH të llogaritet prej 18%. Kjo shumë pastaj duhet të konvertohet në m2 e që operatori ekonomik I rekomanduar për kontratë nuk I ka respektu dhe AK-ATK nuk I ka respektu në vlersimin e tyre. Pastaj AK-ATK në vendimin mbi Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim thuhet që norma e tvsh nuk aplikohet në paga .Ne kompania Laguna sh.p.k. nuk e kemi llogaritur tvsh në paga ashtu siq pretendon AK-ATK por e kemi llogaritur në faturen që I dorëzohet Autoritetit Kontraktues pas kryerjes së shërbimeve. TVSH-në e pagun qdo Operator Ekonomik në bazë të të hyrave dhe shpenzimeve që arrin për një muaj dhe kjo nuk duhet të vi në shprehje në këtë rast në një vlersim të ofertave. Ne edhe vitin e kaluar kemi pasur kontratë me AK-ATK dhe lënda ka qenë në OSHP dhe pretendimet e tona kanë qenë të njëjta vetëm se në ankesen e kaluar kanë qenë 23 puntor e tash 25 puntor. **ANKESA PARAPRAKE KA QENË ME NUMER PROTOKOLLI 418/17 e dates 27.10.2017** dhe OSHP-ja ka kthyer lënden në rivlersim dhe të cilën OSHP-ja edhe ka lëshuar URDHËRES.

Ne kërkojmë nga OSHP-ja që ta aprovon sit ë bazuar ankesen tone dhe lënden ta kthen në Rivlerim në mënyrë që të bëhet vlersimi i drejtë i ofertave

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Kemi humpje materiale dhe profesionale siq janë përgatitja e ofertave, shpenzimi i kohës, sigurimi i tenderit etj

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*